

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari Kujtim Krasniqi, me Zyrtaren Ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kunder te pandehurit E.M.nga P., për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 418 par.1 të KPRK-së i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë / Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.7134/16, të datës 10.01.2017, jashtë seancës, me datë 22.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/II.nr. 7134/16, të datës 10.01.2017, për shqiptimin e urdhërit ndëshkimor,

Andaj gjykata konform nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari;

E.M., nga i ati Xh. dhe e ëma E.,e gjinisë A., i lindur me ...,në P.,me vendbanim në lagjen K. rr.“H.R.”, pn,ku edhe jeton, i pa martuar,ka të kryer shkollën e mesme,i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me date 07.11.2016, rreth orës 18:25 ,në Veternikë, në lokalin Fitnes “G.”, i cili gjendet në “G. S.” në Prishtinë, i pandehuri E.M., ka ushtruar në mënyrë arbitrare të drejtat të cilat ka menduar se i takojnë në vend se ti drejtohet organit kompetent ashtu që pasi kishte punuar si recepcionin e fitnesit pa e pytur askënd nga pazari ditor që ishte bërë në Fitnes “G.”, kishte marrë 296.00,E dhe larguar nga aty,-

- me këtë ka kryer veprën penale Vetëgjyqësia nga neni 418 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjës së formës së prerë të këtij aktgjykimi

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mund ta paguajë deri në 2 (dy) këste mujore në afat kohor prej 2 (dy) muaj, por jo më shumë se 2 (dy) vite nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Obligohet: i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t’ia kompensojnë shumën prej **30 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

I dëmtuari: A.Q., nga P., me vendbanim në B.D. rr. "Ll. ...", në P., lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr. 7134/16, të datës 10.01.2017, kundër të akuzuarit E.M. nga P., për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 418 par.1 të KPRK-së.

Gjykatës i është propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenet 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Kallëzimi penal, Deklarata e te dëmtuarit, si dhe provat tjera përcjellëse janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila ju vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Vetëgjyqësia nga neni 418 par.1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, u mor konform nenet 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenet 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.75/17, të dt. 22.11.2017

Zyrtare Ligjore
Dafian Ymeri

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.